

Prof. G. B. B.



REPUBLIKË E SHQIPËRISË MINISTRI	AKU
Nr. 3753	Prot.
Datë 19.9.2017	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

MINISTRI

*DP 1/10/2017
AKU - ve 8/17
19/09/2017*

URDHËR

Nr. 394, Datë 18.9.2017

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE DERI NË KONSOLIDIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 10614, datë 10.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural",

URDHËROJ:

1. Çdo komunikim i strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfshirë edhe organet e varësisë, me institucionet e medias së shkruar apo asaj vizive duhet të bëhet i bashkërenduar dhe duke koordinuar paraprakisht me Këshilltarin përgjegjës për komunikimin, pranë Zyrës së Kabinetit të Ministrit.
2. Në rast se institucionet e medias së shkruar apo asaj vizive paraqesin kërkesa për informacion, struktura përgjegjëse së cilës i drejtohet, duhet të informojë paraprakisht Këshilltarin përgjegjës për komunikimin, pranë Zyrës së Kabinetit të Ministrit. Në koordinim me Këshilltarin, struktura përgjegjëse përgatit informacionin e kërkuar nga media përkatëse.
3. Në rastet kur për shkak të urgjencës së situatës, strukturat e varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfshirë edhe organet e varësisë, duhet të bëjnë

komunikim të shpejtë (në situatat urgjente të inspektimeve), duhet paraprakisht të njoftojnë nëpërmjet komunikimit telefonik Këshilltarin përgjegjës për komunikimin.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjitha strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfshirë edhe organet e varësisë.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NIKO PELESHI

